

**BASHKIA LEZHË**

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR

Për:

BASHKIMI I OPERATOREVE EKONOMIK “NOVA CONSTRUCTION 2012” SHPK &  
“ANTE-GROUP” SHPK, ME ADRESE NJESIA BASHKIAKE NR. 10, RRUGA KAJO  
KARAFILI, MBRAPA ISH LIDHJES SE SHKRIMTAREVE, PALLATI I SHOQERISE MC  
INERTE , TIRANE

OPERATORI EKONOMIK “GJIKURIA” SHPK, ME ADRESE NJESIA BASHKIAKE NR. 5,  
RRUGA IBRAHIM RUGOVA, PRANE GARDES SE REPUBLIKES, PALLATI KONTAKT,  
MBI UNION BANK, TIRANE

\* \* \*

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Pershpejtuar Rindertimi”, E Kufizuar/ Pune, Marrëveshje  
Kuaër”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-83280-12-28-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rindertimi i shkolles 9-vjeçare "At Zef Pllumbi", Njesia

Administrative Shengjin, Bashkia Lezhe, ne kuader te procesit te Rindertimit”.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: 12 Muaj nga data e nënshkrimit te marrëveshjes Kuader.

Kohëzgjatja e parashikuar e kontratës: 6 muaj nga data e nënshkrimit te kontrates.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X oferta ekonomikisht më e favorshme □ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “NOVA Construction 2012” shpk, me Nuis L22404012D & “Ante-Group” shpk, me Nuis J62904100D.
- 2- Operatori Ekonomik “GJIKURIA” Shpk, me Nuis J62903456H.
- 3- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “SIRETA 2F” Shpk, me Nuis K51501008J & “AGRI CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis K01725001F & “CARA” Shpk, me Nuis K07729920F.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- 1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “SIRETA 2F” Shpk, me Nuis K51501008J & “AGRI CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis K01725001F & “CARA” Shpk, me Nuis K07729920F.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “SIRETA 2F” Shpk, me Nuis K51501008J & “AGRI CONSTRUCTION” Shpk, me Nuis K01725001F & “CARA” Shpk, me Nuis K07729920F.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

*Se pari* ne piken 2.3.2 te kriterave te veçanta parashikohet se: Operoret ekonomike duhet te deshmojne se disponojne license profesionale per zbatim punimesh ne ndertim si dhe per kategorite e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkate se te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008; *Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi*”, i ndryshuar.

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI: NP-1 B, NP-2 E, NP-4 A, NP-11 A, NP-12 E

PUNIME SPECIALE NDERTIMI: NS -1 B, NS-2 B, NS-4 D, NS-8 B, NS-9 A, NS-12 B, NS-13 A, NS-14 C, NS-16 A, NS-18 A

Nga verifikimi rezulton se asnjë nga Operoret e BOE-se “Cara” Shpk, “Sireta 2F” Shpk dhe “Agri Construction” Shpk nuk disponojne licensen ne kategorine e kerkuar ne DST per NP-12 E, pasi nga

verifikimi rezulton se OE “Cara” Shpk disponon NP-12 B, OE “Sireta 2F” disponon NP-12 D dhe “Agri Construction” Shpk disponon NP-12 D. Sa me sipër BOE nuk permushur kete kriter te kerkuar nga AK.

*Se dyti* ne piken 2.3.7 te kritereve te veçanta parashikohet se: Operatori ekonomik te disponoje licence mjedisore si vijon: Të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte” dhe (QKL) Kodi III.2.B, Grumbullim dhe transportim i ujrave te ndotura urbane, llumrave septike dhe ujrave te zeza.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se asnjë nga Operoret e BOE-se “Cara” Shpk, “Sireta 2F” Shpk dhe “Agri Construction” Shpk nuk disponojnë Licence (QKL) Kodi III.2.B me veprimtari “Grumbullim dhe transportim i ujrave te ndotura urbane, llumrave septike dhe ujrave te zeza”.

*Se treti* ne piken 2.3.4/a, parashikohet se: Operatori duhet te deshmoje se ka drejtues teknik qe do te angazhohet per realizimin e punimeve stafin e meposhtem:

a.Stafi i drejtuesve teknik i shoqërisë të ketë në përbërje:

Inxhinier Hidroteknik 1; Inxhinier Ndertimi 2; Inxhinier Mekanik 1; Inxhinier Topograf 1; Inxhinier Elektrik 1; Inxhinier elektronik 1; Inxhinier Mjedisi 1(Profili Energjitike i pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit); Arkitekt 1. Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet te jetë ne Listëpagesat te pakten per periudhen Dhjetor 2019 – Nentor 2020 si dhe te figurojne në licensën e shoqërisë.

Nga verifikimi i licencave te shoqërive pjese te BOE-se rezulton se per Drejtuesin Teknik me Profil Inxhinier Elektronik e disponon shoqëria “Cara” Shpk por ne SPE nuk ka paraqitur listepagesen përkatëse per Muajin Dhjetor 2019, duke mos provuar disponimin e këtij drejtuesi teknik per periudhën e kërkuar ne DST.

*Se kateri* ne piken 2.3.4/b, parashikohet se: Operatori duhet te deshmoje se kane staf mbështetës qe do te angazhohet per realizimin e punimeve si meposhte:

-Teknik Ndertimi 3 (tre), te paisur me Diplome te Shkolles se Mesme.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se: Eshte paraqitur dokumentacion nga OE “Agri Construction” Shpk, per dy nga punonjësit e tij qe disponojnë diplome te shkollës se mesme per kategorinë teknik ndërtimi, konkretisht per Z. Ramazan Beqiri dhe Z. Fatmir Koçi. Sa i përket punonjësve te tjerë te paraqitur si Teknik Ndertimi nga dy operoret tjerë te BOE-se, nuk e përmbushin kete kriter pasi per këto te fundit nuk janë ngarkuar ne SPE, diplomat përkatëse te Shkolles se Mesme si teknik Ndertimi.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e

nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit” vendosi të refuzojë ofertën e BOE “SIRETA 2F” Shpk & “AGRI CONSTRUCTION” Shpk & “CARA” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. të ndryshuar, BOE BOE “SIRETA 2F” Shpk & “AGRI CONSTRUCTION” Shpk & “CARA” Shpk, *skualifikohet*.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

1. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “NOVA Construction 2012” shpk, me Nuis L22404012D & “Ante-Group” shpk, me Nuis J62904100D.
2. Operatori Ekonomik “GJIKURIA” Shpk, me Nuis J62903456H.

*Shënim: Referuar VKM nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, kualifikimi i ofertuesëve në fazën e parë, nuk është me pikë.*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Bashkise Lezhe, brenda 2 (dy) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 21.01.2021

Ankesa: Nuk Ka